



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 5282/11 Prot.

Pogradec, më 18.11.2021

VENDIM

NR. 99, DATË 18.11.2021

PËR

**DISA SHTESA, NDRYSHIME DHE SAKTËSIME NË VENDIMI I KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC NR. 83, DATË 19.10.2021, "PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC TË DISA OBJEKTEVE USHTARAKE TE NDODHURA NE TERITORIN E BASHKISE POGRADEC, NGA MINISTERIA E MBROJTJES", I KTHYER NGA INSTITUCIONI I PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË, ME SHKRESËN NR. 1003/2 PROT, DATË 29.10.2021.**

Në mbështetje të; nenit 13, nenit 108, nenit 109, nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, shkronjës "e" të nenit 54, shkronjës "i" të nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 162, nenit 163, Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 3, nenit 4, nenit 5 të Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, Vendimit nr. 500, datë 14.8.2001 të Këshillit të Ministrave "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, Udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", si dhe referuar shkresës të Shtabit të përgjithshëm të Forcave të Armatosura Nr. 813 prot, datë 26.02.2021, "Kërkesë për bashkëpunim", shkresës së Bashkisë Pogradec Nr. 1021/1 Prot, datë 08.03.2021, "Kthim përgjigje", shkresës së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Nr. 959 Prot, datë 18.03.2021, "Kërkesë për bashkëpunim për moscënimin e pronave të paluajtshme shtetërore në administrim të Ministrisë së Brendshme", shkresës së Bashkisë Pogradec Nr. 1440/1 Prot, datë 30.03.2021, "Kërkesë për vazhdim procedurash", shkresës së Bashkisë Pogradec Nr.


1440 Prot, datë 30.03.2021, "Kërkesë për vazhdim procedurash", shkresës të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Nr. 697/2 Prot, datë 13.04.2021, "Kthim përgjigje shkresës Tuaj nr. 1440/1, datë 30.03.2021", shkresës të Ministrisë së Mbrojtjes Nr. 2477/1 Prot, datë 31.05.2021, "Kërkesë për bashkëpunim", shkresës të Bashkisë Pogradec Nr. 2519/1 Prot, datë 15.06.2021, "Kërkesë për vazhdim procedurash", shkresës së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Nr. 2136/1 Prot, datë 25.06.2021, "Kthim përgjigje shkresës Tuaj nr. 2519/1, datë 15.06.2021", shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes Nr. 3460 Prot, datë 15.07.2021, "Kthim përgjigje shkresës nr. 2519/1 prot, datë 15.06.2021", shkresës së Prefektit të Qarkut Korçë Nr. 541/2 Prot, datë 14.09.2021, "Në vëmendjen Tuaj lidhur me vazhdimin e procedurave për kalimin në pronësi të pronave ushtarake", pasi vlerësojmë se arsyet e moskonfirmimit të bazueshmërisë ligjore të përshkruara në shkresë e Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë Nr. 1003/2 prot, datë 29.10.2021, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit", bazuar në relacioni i paraqitur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

## KËSHILLI I BASHKISË

### VENDOSI :

1. Të bëhen disa shtesa, ndryshime dhe saktësime në Vendimi i Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 83, datë 19.10.2021, "Për fillimin e procedurave për transferimin në pronësi të bashkisë pogradec të disa objekteve ushtarake të ndodhura në territorin e Bashkisë Pogradec, nga Ministria e Mbrojtjes", i kthyer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, me shkresën nr. 1003/2 prot, datë 29.10.2021, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit", të pasqyruara sim ë poshtë vijon:

Nr. rendor	Nr.i pronës sipas VKM Nr. 515, datë 18.07.2003, të ndryshuar	Emërtesa e pronës, vendndodhja, shtrirja gjeografike.	Adresa e pronës	Sipërfaqja/përmasa e pronës në m <sup>2</sup>	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	580	"Ish pularia Reparti Ushtarak 1015"	Guras (Zakorçan) Pogradec	16 000	Prona do të përdoret për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.	Pronesi
2	576	"Lavanteri e ish Rep.Usht 1015"	Verdove, Buçimas ,Pogradec	192	Prona do të përdoret për ushtrimin e funksioneve administrative.	Pronesi
3	579	"Ish Repart Ushtarak	Guras (Zakorçan)	15 000	Prona do të përdoret për	Pronesi



		1015"	,Starove, Pogradec		ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.	
4	575	"Depo e FV Rep.Usht 4001"	Godina Nr.1, Verdove Pogradec	125	Prona do të përdoret për ushtrimin e funksioneve administrative.	Pronesi
5	583	Ish kompani mitraliere Rep.Usht 4001"	Peshkepi Pogradec	49 930.6	Prona do të përdoret për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.	Pronesi
6	586	Ish batalion kembesorie Rep.Usht 4001	Çërravë Pogradec	29790.6	Prona do të përdoret për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.	Pronesi
7	592	Grup Depo Municioni Rep.Usht 4001	Qafa e Lipovës Varri Grekut Pogradec	111 776.47	Prona do të përdoret për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.	Pronesi
8	1213	PVQ Rep.Usht 4001	Mali Qytetit Pogradec	1605,03	Prona do të përdoret për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.	Pronesi
9	587	Ish Repart Ushtarak (Rep.Usht 4001)	Alarup Cerrave Pogradec	60 609.28	Prona do të përdoret për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.	Pronesi
10	Mungon në listën e	Godina e forcave	Fshati Proptisht	14 100	Prona so të përdoret për	Pronesi

	ushtrisë.	vullnetare Rep.Usht 4001	Pogradec		ushtrimin e funsioneve të tyre administrative.	
11	Mungon në listën e ushtrisë.	Godina eforcave vullnetare Rep.Usht 4001	Fshati Trebinjë Pogradec	15 012	Prona do të përdoret për ushtrimin e funsioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.	Pronesi

2. Pasuritë e mësipërme, do të përdoren për ushtrimin e detyrave funksionale të Bashkisë Pogradec, sipas fushës së përdorimit të përcaktuar në këtë vendim.

3. Efektet: Kalimi në pronësi i këtyre pronave, do të ndihmojë në ushtrimin sa më efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia Pogradec.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec, që të kryejnë të gjitha procedurat përkatëse ligjore, deri në vendimarrjen e Këshillit të Ministrave, për kalimin e pronësisë.

5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

6. U shpall sot më datë 18.11.2021.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Sotiraq MANGËRI**

